



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 135 Prot

Tiranë, më 24, 02, 2015

VENDIM Nr. 9, datë 18.02.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 2, të datës 18.02.2015, pasi shqyrtoi "Relacionin mbi verifikimin e punimeve të kryera nga subjekti "Vega Construction" sh.p. k. pranë fshatit Qesarat, Tepelenë", realizuar nga ASHA, në kuadër të projektit Levan-Tepelenë, Loti 2, paraqitur nga subjekti "Autoriteti Rrugor Shqiptar",

VENDOSI:

- I. Autoriteti Rrugor Shqiptar të depozitojë pranë ASHA projektin e zbatimit për segmentin e rrugës, në të gjithë gjatësinë e fshatit Qesarat, Tepelenë, pjesë e projektit Levan-Tepelenë, Loti 2.
- II. Për këtë segment rrugor të kryhen sondazhe arkeologjike nga ASHA, duke lidhur aktmarrëveshje përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, raporti i të cilave të paraqitet në KKA e radhës.
- III. Për punimet e realizuara pa projekt të miratuar, në segmentin e rrugës Levan-Tepelenë, Loti 2, pranë fshatit Qesarat KM 13+600, të njoftohen organet përkatëse për vendosjen e gjobës ndaj subjektit përgjegjës për to.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO